



## Titulli i projektit

Zyra e Shërbimeve me Një Ndalesë - ZSHNJN (Bashkia Mat)

## Tipi i projektit

Shërbimet Publike

## Vendndodhja e projektit

Burrel, Komsì, Lis, Macukull, Baz, Ulëz, Rukaj, Derjan,

## Buxheti i paravlerësuar

Për t'u përcaktuar, por jo më pak se 25,000,000 lekë

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Në situatën e re të dalë nga shkrija dhe bashkimi i njësive të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Ruajtja e stadi të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirësimi i mëtejshëm, janë tendenca që duhet të ecin paralelisht. Aktualisht, shërbimet publike në Burrel ofrohen me sistemin e Zyrës me Një Ndalesë. Ky sistem duhet të shtrihet dhe të integrohet me njësitë e tjera, që do shkrihen me bashkinë e Burrelit, konkretisht në njësitë: Komsì, Lis, Macukull, Baz, Ulëz, Rukaj, Derjan. Kjo është e rëndësishme sidomos për shërbimet e mbështetjes së zhvillimit ekonomik (dhënie licensash, lejesh për ushtrim aktiviteti, pagime tarifash dhe taksash lokale, planifikim urban, mirëmbajtje e pyjeve, etj.), si dhe shërbimet e tjera të karakterit administrativ (gjëndja civile, përkrahja sociale, etj.). Ofrimi i shërbimeve me një zyrë mbështetëse dhe disa zyra pararojë në secilën nga njësitë shkrija, do të risë efektivitetin e shërbimit, duke ruajtur shkallën e shërbimit të arritur.


## Qëllimi/et specifik të projektit

ZSHNJN do të sigurojë shërbimet publike në zonat e shkrija në mënyrë më efektive dhe me cilësi më të lartë, duke rritur transparencën me publikun.

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Rritja e efektivitetit të shërbimeve publike për qytetarët e bashkisë Mat (total i popullsisë më tepër se 27000 banorë);
- Zvogëlimi i kostos së shërbimeve publike për banorë, si pasojë e zvogëllimit të kostos së personelit dhe të kohës së harxhuar për njësi shërbimi ( më tepër se 30%);
- Rritja e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet futjes së praktikës së shërbimeve të hapura (100%).

# PROJEKTI 1



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

- Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një ZSHNJN;
- Rinovimi dhe adaptimi i ambientit të ZSHNJN;
- Kompletimi i ZSHNJN me pajisjet bazë;
- Punësim personeli, trajnimi dhe testimi
- Zhvillimi i materialeve promociionale (logo e ZSHNJN, shenja, fletushka, kuti postare për qytetarët, komentet dhe ankesat).

## Maturimi i projektit

Ka një praktikë ekzistuese në bashkinë e Burrelit, e cila duhet të shtrihet në bashkitë e tjera që do të shkrihen në kuadrin e njësisë së re Mat. Ekziston një projekt pilot i zhvilluar nga programi dldp për njësinë Lezhë, apo Kallmet, që mund të zbatohet në këto zona.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

- Burimet e Finacimit:
- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
  - Transferata e Pakushtëzuar
  - Donatorët
  - Fondi i Mbështetjes së Decentralizimit
- Partnerët:
- Bashkia Mat
  - Qeveria Qëndrore dhe Këshilli i Qarkut
  - Donatorë: UNDP, OSBE, BE

## Kostot e projektit

Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një ZSHNJN  
Rinovimi dhe adaptimi i ambientit ZSHNJN  
Kompletimi i ZSHNJN me pajisjet bazë  
Punësim personeli, trajnimi dhe testimi  
Zhvillimi i materialeve promociionale  
Total: Jo më pak se 25,000,000 lekë